Nr.	Akti	Datë regj.	Objekti	Datë shorti	Datë nxjerrje për gjykim	Nr. vendimi	Datë vendimi	Datë dorëzimi vendim i arsyetuar	Koha (afati) i arsyetimit	Afati i përfundimit të gjykimit	Krahasuar me		Relator	Anëtar	Transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht në gjykatë tjetër	Nr. Seancave gjyqësore	Seancë audio
											afati ligjor	standard minimal kohor					



Tabela Nr. 26

TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE KËRKESA PENALE TË FAZËS SË EKZEKUTIMIT DHE MARRËDHËNIEVE JURIDIKSIONALE ME JASHTË TË GJYQTARIT_____ TË GJYKATËS SË APELIT_____ PËR VITIN _____																	
Nr.	Akti	Datë regj.	Objekti	Datë shorti	Datë nxjerrje për gjykim	Nr. vendimi	Datë vendimi	Datë dorëzimi vendim i arsyetuar	Koha (afati) i arsyetimit	Afati i përfundimit të gjykimit	Krahasuar me		Relator	Anëtar	Transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht në gjykatë tjetër	Nr. Seancave gjyqësore	Seancë audio
											afati ligjor	standard minimal kohor					



Tabela Nr. 27

TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE ANTIMAFIA TË GJYQTARIT_____ TË GJYKATËS SË APELIT_____ PËR VITIN _____																	
Nr.	Akti	Datë regj.	Objekti	Datë shorti	Datë nxjerrje për gjykim	Nr. vendimi	Datë vendimi	Datë dorëzimi vendim i arsyetuar	Koha (afati) i arsyetimit	Afati i përfundimit të gjykimit	Krahasuar me		Relator	Anëtar	Transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht në gjykatë tjetër	Nr. Seancave gjyqësore	Seancë audio
											afati ligjor	standard minimal kohor					



Tabela Nr. 28

TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE JURIDIKSION FILLESTAR TË GJYQTARIT _____ TË GJYKATËS SË APELIT _____ PËR VITIN _____																	
Nr.	Akti	Datë regj.	Objekti	Datë shorti	Datë nxjerrje për gjykim	Nr. vendimi	Datë vendimi	Datë dorëzimi vendim i arsyetuar	Koha (afati) i arsyetimit	Afati i përfundimit të gjykimit	Krahasuar me		Relator	Anëtar	Transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht në gjykatë tjetër	Nr. Seancave gjyqësore	Seancë audio
											afati ligjor	standard minimal kohor					



Tabela Nr. 29

TABELË PËRMBLEDHËSE, ME TË DHËNA STATISTIKORE PËR SASINË, SHPEJTËSINË, PËRJASHTIMET DHE HEQJET DORË NGA GJYKIMI PËR GJYQTARIN _____ E GJYKATËS SË APELIT - PËR VITIN _____																
Nr.	Natyrë e çështjeve gjyqësore	Çështjet e mbartura nga viti i kaluar	Çështjet e caktuara si relator	Çështjet e përfunduara si relator	Rendimenti	Çështjet e përfunduara si anëtar	Çështjet e caktuara si i transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht në gjykatë tjetër	Çështjet e përfunduara si i transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht në gjykatë tjetër	Çështjet e përfunduara si relator jashtë afatit ligjor	Çështjet e përfunduara si relator jashtë afatit standard minimal kohor	Kërkesa përjashtim gjyqtari	Pranuar	Rrëzuar	Heqje dorë	Pranuar	Rrëzuar
1	Civile të përgjithshme me palë kundërshtare															
2	Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare															
3	Familjare me palë kundërshtare															
4	Familjare pa palë kundërshtare															
5	Tregtare me palë kundërshtare															
6	Tregtare pa palë kundërshtare															
7	Marrëdhënie pune															
8	Penale krime															
9	Penale kundërvajtje															
10	Kërkesa penale hetimit paraprak															
11	Seancë paraprake															
12	Kërkesa faza e ekzekutimit e marrëdhëniet juridiksionale me jashtë															
13	Antimafia															
14	Juridiksion fillestar															
Totali																



Tabela Nr. 30

TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE ME PALË KUNDËRSHTARE TË GJYQTARIT _____ TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË _____ PËR VITIN _____																
Nr	Akti	Datë regj.	Objekti	Datë shorti	Nr. vendimi	Datë vendimi	Datë dorëzimi vendimi arsyetuar	Koha (afati) arsyetimit	Afati i përfundi mit të gjykimit	Krahasuar me		Relator	Anëtar	Transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht në gjykatë tjetër	Nr. Seancave gjyqësore	Seanca audio
										afati ligjor	standard minimal kohor					



Tabela Nr. 31

**TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE PA PALË KUNDËRSHTARE TË GJYQTARIT _____ TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE
TË SHKALLËS SË PARË _____ PËR VITIN _____**

Nr	Akti	Datë regj.	Objekti	Datë shorti	Nr. vendimi	Datë vendimi	Datë dorëzimi vendimi arsyetuar	Koha (afati) arsyetimit	Afati i përfundi mit të grykimit	Krahasuar me		Relator	Anëtar	Transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht në grykatë tjetër	Nr. seancave gryqësore	Seanca audio
										afati ligjor	standard minimal kohor					



Tabela Nr. 32

TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE MARRËDHËNIE PUNE TË GJYQTARIT _____ TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË _____ PËR VITIN _____																
Nr	Akti	Datë regj.	Objekti	Datë shorti	Nr. vendimi	Datë vendimi	Datë dorëzimi vendimi arsyetuar	Koha (afati) arsyetimit	Afati i përfundi mit të gjykimit	Krahasuar me		Relator	Anëtar	Transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht në gjykatë tjetër	Nr. Seancave gjyqësore	Seanca audio
										afati ligjor	standard minimal kohor					



Tabela Nr. 33

TABELË PËRMBLEDHËSE, ME TË DHËNA STATISTIKORE PËR SASINË, SHPEJTËSINË, PËRJASHTIMET DHE HEQJET DORË NGA GJYKIMI PËR GJYQTARIN _____ TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË _____ PËR VITIN _____																
Nr	Natyra e çështjeve gjyqësore	Çështjet e mbartura nga viti i kaluar	Çështjet e caktuara si relator	Çështjet e perfunduara si relator	Rendimenti	Çështjet e perfunduara si anëtar	Çështjet e caktuara si transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht në gjykatë tjetër	Çështjet e perfunduara si transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht në gjykatë tjetër	Çështjet e perfunduara si relator jashtë afatit ligjor	Çështjet e perfunduara si relator jashtë afatit standard minimal kohor	Kërkesa përjashtim gjyqtari	Pranuar	Rrëzuar	Heqje dorë	Pranuar	Rrëzuar
1	Me palë kundërshtare															
2	Marrëdhënie pune															
3	Pa palë kundërshtare															
Totali																



Tabela Nr. 34

TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE ME PALË KUNDËRSHTARE TË GJYQTARIT _____ TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË APELIT TIRANË PËR VITIN _____																	
Nr	Akti	Datë regj.	Objekti	Datë shorti	Datë nxjerrje për gjykim	Nr. vendimi	Datë vendimi	Datë dorëzimi vendimi arsyetuar	Koha (afati) arsyetimit	Afati i përfundi mit të gjykimit	Krahasuar me		Relator	Anëtar	Transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht në gjykatë tjetër	Nr. Seancave gjyqësore	Seanca audio
											afati ligjor	standard minimal kohor					



Tabela Nr. 35

TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE PA PALË KUNDËRSHTARE TË GJYQTARIT _____ TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË APELIT TIRANË PËR VITIN _____																	
Nr	Akti	Datë regj.	Objekti	Datë shorti	Datë nxjerrje për gjykim	Nr. vendimi	Datë vendimi	Datë dorëzimi vendimi arsyetuar	Koha (afati) arsyetimit	Afati i përfundi mit të gjykimit	Krahasuar me		Relator	Anëtar	Transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht në gjykatë tjetër	Nr. Seancave gjyqësore	Seanca audio
											afati ligjor	standard minimal kohor					



Tabela Nr. 36

TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE MARRËDHËNIE PUNE TË GJYQTARIT _____ TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË APELIT TIRANË PËR VITIN _____																	
Nr	Akti	Datë regj.	Objekti	Datë shorti	Datë nxjerrje për gjykim	Nr. vendimi	Datë vendimi	Datë dorëzimi vendimi arsyetuar	Koha (afati) arsyetimit	Afati i përfundi mit të gjykimit	Krahasuar me		Relator	Anëtar	Transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht në gjykatë tjetër	Nr. Seancave gjyqësore	Seanca audio
											afati ligjor	standard minimal kohor					



Tabela Nr. 37

TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE JURIDIKSION FILLESTAR TË GJYQTARIT _____ TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË APELIT TIRANË PËR VITIN _____																	
Nr	Akti	Datë regj.	Objekti	Datë shorti	Datë nxjerrje për gjykim	Nr. vendimi	Datë vendimi	Datë dorëzimi vendimi arsyetuar	Koha (afati) arsyetimit	Afati i përfundi mit të gjykimit	Krahasuar me		Relator	Anëtar	Transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht në gjykatë tjetër	Nr. Seancave gjyqësore	Seanca audio
											afati ligjor	standard minimal kohor					



Tabela Nr. 38

TABELË PËRMBLEDHËSE, ME TË DHËNA STATISTIKORE PËR SASINË, SHPEJTËSINË, PËRJASHTIMET, HEQJET DORË NGA GJYKIMI PËR GJYQTARIN E GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË APELIT PËR VITIN _____																
Nr.	Natyra e çështjeve gjyqësore	Çështjet e mbartura nga viti i kaluar	Çështjet e caktuara si relator	Çështjet e perfunduara si relator	Rendimenti	Çështjet e perfunduara si anëtar	Çështjet e caktuara si transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht në gjykatë tjetër	Çështjet e perfunduara si transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht në gjykatë tjetër	Çështjet e përfunduara si relator jashtë afatit ligjor	Çështjet e përfunduara si relator jashtë afatit standard minimal kohor	Kërkesa përjashtim gjyqtari	Pranuar	Rrëzuar	Heqje dorë	Pranuar	Rrëzuar
1	Me palë kundërshtare															
2	Marrëdhënie pune															
3	Pa palë kundërshtare															
4	Juridiksion fillestar															
Totali																



Tabela Nr. 39

**TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE THEMELI PER KRIME
TË GJYQTARIT TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË PËR KRIME TË RËNDA/ KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR
PËR VITIN _____**

Nr	Akti	Datë regj.	Objekti	Datë shorti	Numër vendimi	Datë vendimi	Datë dorëzimi vendimi arsyetuar	Koha (afati) arsyetimit	Afati i përfundimit të gjykimit	Krahasuar me		Relator	Anëtar	Transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht në gjykatë tjetër	Nr. Seancave gjyqësore	Seanca audio
										afati ligjor	standard minimal kohor					



Tabela Nr. 40

**TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TE HETIMIT PARAPRAK
TË GJYQTARIT TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË PËR KRIME TË RËNDA/ KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR
PËR VITIN _____**

Nr	Akti	Datë regj.	Objekti	Datë shorti	Numër vendimi	Datë vendimi	Datë dorëzimi vendimi arsyetuar	Koha (afati) arsyetimit	Afati i përfundimit të gjykimit	Krahasuar me		Relator	Anëtar	Transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht në gjykatë tjetër	Nr. Seancave gjyqësore	Seanca audio
										afati ligjor	standard minimal kohor					



Tabela Nr. 41

**TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE SEANCË PARAPRAKE
TË GJYQTARIT TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË PËR KRIME TË RËNDA/ KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR
PËR VITIN _____**

Nr	Akti	Datë regj.	Objekti	Datë shorti	Numër vendimi	Datë vendimi	Datë dorëzimi vendimi arsyetuar	Koha (afati) arsyetimit	Afati i përfundimit të gjykimit	Krahasuar me		Relator	Anëtar	Transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht në gjykatë tjetër	Nr. Seancave gjyqësore	Seanca audio
										afati ligjor	standard minimal kohor					



Tabela Nr. 42

**TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE KËRKESA GJATE FAZES SE EKZEKUTIMIT
TË GJYQTARIT TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË PËR KRIME TË RËNDA/ KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR
PËR VITIN _____**

Nr	Akti	Datë regj.	Objekti	Datë shorti	Numër vendimi	Datë vendimi	Datë dorëzimi vendimi arsyetuar	Koha (afati) arsyetimit	Afati i përfundimit të gjykimit	Krahasuar me		Relator	Anëtar	Transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht në gjykatë tjetër	Nr. Seancave gjyqësore	Seanca audio
										afati ligjor	standard minimal kohor					



Tabela Nr. 43

**TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE KERKESA NË BAZË TË LIGJIT ANTIMAFIA
TË GJYQTARIT TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË PËR KRIME TË RËNDA/ KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR
PËR VITIN _____**

Nr	Akti	Datë regj.	Objekti	Datë shorti	Numër vendimi	Datë vendimi	Datë dorëzimi vendimi arsyetuar	Koha (afati) arsyetimit	Afati i përfundimit të gjykimit	Krahasuar me		Relator	Anëtar	Transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht në gjykatë tjetër	Nr. Seancave gjyqësore	Seanca audio
										afati ligjor	standard minimal kohor					



Tabela Nr. 44

TABELË PËRMBLEDHËSE, ME TË DHËNA STATISTIKORE PËR SASINË, SHPEJTËSINË, PËRJASHTIMET DHE HEQJET DORË NGA GJYKIMI PËR GJYQTARIN E GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË PËR KRIME TË RËNDA/ KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR _____ PËR VITIN _____

Nr.	Natyra e çështjeve gjyqësore	Çështjet e mbartura nga viti i kaluar	Çështjet e caktuara si relator	Çështjet e perfunduara si relator	Rendimenti	Çështjet e perfunduara si anëtar	Çështjet e caktuara si transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht në gjykatë tjetër	Çështjet e perfunduara si i transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht në gjykatë tjetër	Çështjet e perfunduara si relator jashtë afatit ligjor	Çështjet e perfunduara si relator jashtë afatit standard minimal kohor	Kërkesa përjashtim gjyqtari	Pranuar	Rrëzuar	Heqje dorë	Pranuar	Rrëzuar
1	Krime															
2	Antimafia															
3	Kërkesa penale hetimit paraprak															
4	Seancë paraprake															
5	Kërkesa penale faza e ekzekutimit															
Totali																



Tabela Nr. 45

TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE ANTIMAFIA TË GJYQTARIT TË GJYKATËS SË APELIT PËR KRIME TË RËNDA/ KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR _____ PËR VITIN _____																	
Nr	Akti	Datë regj.	Objekti	Datë shorti	Datë nxjerrje për gjykim	Numër vendimi	Datë vendimi	Datë dorëzimi vendimi arsyetuar	Koha (afati) arsyetimit	Afati i përfundimit të gjykimit	Krahasuar me		Relator	Anëtar	Transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht në gjykatë tjetër	Nr. Seancave gjyqësore	Seanca audio
											afati ligjor	standard minimal kohor					



Tabela Nr. 46

**TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË HETIMIT PARAPRAK
TË GJYQTARIT TË GJYKATËS SË APELIT PËR KRIME TË RËNDA/ KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR
PËR VITIN _____**

Nr	Akti	Datë regj.	Objekti	Datë shorti	Datë nxjerrje për gjykim	Numër vendimi	Datë vendimi	Datë dorëzimi vendimi arsyetuar	Koha (afati) arsyetimit	Afati i përfundimit të gjykimit	Krahasuar me		Relator	Anëtar	Transferuar për kohësisht ose i caktuar për kohësisht në gjykatë tjetër	Nr. Seancave gjyqësore	Seanca audio
											afati ligjor	standard minimal kohor					



Tabela Nr. 47

TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE SEANCË PARAPRAKE TË GJYQTARIT TË GJYKATËS SË APELIT PËR KRIME TË RËNDA/ KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR _____ PËR VITIN _____																	
Nr	Akti	Datë regj.	Objekti	Datë shorti	Datë nxjerrje për gjykim	Numër vendimi	Datë vendimi	Datë dorëzimi vendimi arsyetuar	Koha (afati) arsyetimit	Afati i përfundimit të gjykimit	Krahasuar me		Relator	Anëtar	Transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht në gjykatë tjetër	Nr. Seancave gjyqësore	Seanca audio
											afati ligjor	standard minimal kohor					



Tabela Nr. 48

TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE FAZA E EKZEKUTIMIT TË GJYQTARIT TË GJYKATËS SË APELIT PËR KRIME TË RËNDA/ KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR _____ PËR VITIN _____																	
Nr	Akti	Datë regj.	Objekti	Datë shorti	Datë nxjerrje për gjykim	Numër vendimi	Datë vendimi	Datë dorëzimi vendimi arsyetuar	Koha (afati) arsyetimit	Afati i përfundimit të gjykimit	Krahasuar me		Relator	Anëtar	Transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht në gjykatë tjetër	Nr. Seancave gjyqësore	Seanca audio
											afati ligjor	standard minimal kohor					



Tabela Nr. 49

TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE KRIME TË GJYQTARIT TË GJYKATËS SË APELIT PËR KRIME TË RËNDA/ KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR _____ PËR VITIN _____																	
Nr	Akti	Datë regj.	Objekti	Datë shorti	Datë nxjerrje për gykim	Numër vendimi	Datë vendimi	Datë dorëzimi vendimi arsyetuar	Koha (afati) arsyetimit	Afati i përfundimit të gjykimit	Krahasuar me		Relator	Anëtar	Transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht në gjykatë tjetër	Nr. Seancave gjyqësore	Seanca audio
											afati ligjor	standard minimal kohor					



Tabela Nr. 50

TABELË PËRMBLEDHËSE, ME TË DHËNA STATISTIKORE PËR SASINË, SHPEJTËSINË, PËRJASHTIMET DHE HEQJET DORË NGA GJYKIMI PËR GJYQTARIN E GJYKATËS SË AELIT PËR KRIME TË RËNDA/ KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR PËR VITIN _____

Nr.	Natyra e çështjeve gjyqësore	Çështjet e mbartura nga viti i kaluar	Çështjet e caktuara si relator	Çështjet e përfunduara si relator	Rendimenti	Çështjet e përfunduara si anëtar	Çështjet e caktuara si transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht në gjykatë tjetër	Çështjet e përfunduara si transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht në gjykatë tjetër	Çështjet e përfunduara si relator jashtë afatit ligjor	Çështjet e përfunduara si relator jashtë afatit standard minimal kohor	Kërkesa përjashtim gjyqtari	Pranuar	Rrëzuar	Heqje dorë	Pranuar	Rrëzuar
1	Krime															
2	Antimafia															
3	Kërkesa penale të hetimit paraprak															
4	Seancë paraprake															
5	Kërkesa penale faza e ekzekutimit															
	Totali															



VENDIM

Nr. 78, datë 18.12.2019

**PËR DISA NDRYSHIME NË
RREGULLOREN “PËR PARANDALIMIN
E PASTRIMIT TË PARAVE DHE
FINANCIMIT TË TERRORIZMIT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 9 dhe nenit 126, pika 2, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar; të nenit 60, pika 1, dhe nenit 66, të ligjit nr. 52/2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”; dhe të ligjit nr. 157/2013, datë 10.10.2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, miratuar me vendimin nr. 44, datë 10.6.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 1, pas togfjalëshit “nga subjektet e kësaj rregulloreje,” shtohet togfjalëshi “për qëllime të administrimit të rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”;

b) Neni 4 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 9 dhe të nenit 126, pika 2, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 60, pika 1, dhe të nenit 66, të ligjit nr. 52/2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar; dhe të ligjit nr. 157/2013, datë 10.10.2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar.”;

c) Në nenin 5 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në pikën 1, pas togfjalëshit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, shtohet togfjalëshi “; i ndryshuar”;

ii. në pikat 1 dhe 2, pas togfjalëshit “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, shtohet togfjalëshi “; i ndryshuar”;

iii. në pikën 1, pas togfjalëshit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, shtohet togfjalëshi “; i ndryshuar”;

d) Titulli i kreut II ndryshon në: “Vigjilenca e thyeshituar, vigjilenca e dubur dhe vigjilenca e zgjeruar”;

e) Në nenin 6 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në pikën 1, pas togfjalëshit “marrin masat e”, shtohet togfjalëshi “vigjencës së thyeshituar”;

ii. në pikën 2, togfjalëshi “në përputhje me nenin 2, pika 21, si dhe nenin 11”, zëvendësohet me togfjalëshin “siç përcaktohet në nenin 2, pika 21, si dhe në nenet 11 dhe 12”;

iii. në pikën 5, togfjalëshi “ose fotokopje e notuar.”, zëvendësohet me togfjalëshin “ose fotokopje të noterizhuara ose dokument elektronik që plotëson kushtet e vlefshmërisë, sipas legjislacionit në fuqi për dokumentin elektronik ose nënshkrimin elektronik.”;

iv. në pikën 5, dy fjalitë e fundit me përmbajtjen: “Subjektet, në momentin e vendosjes së marrëdhënieve të biznesit ose të kryerjes së transaksionit/eve, mbajnë në dosjen e klientit kopje të dokumenteve të paraqitura nga ky i fundit. Kopjet e këtyre dokumenteve duhet të jenë të vulosura me vulën e subjektit, brenda afatit të vlefshmërisë së tyre.”, zëvendësohen me një fjali, me përmbajtjen: “Subjektet, në momentin e vendosjes së marrëdhënieve të biznesit ose të kryerjes së transaksionit/eve, mbajnë në dosjen e klientit kopje të dokumenteve të paraqitura nga ky i fundit në formën e mësipërme, të cilat duhet të jenë të vulosura me vulën e subjekteve të kësaj rregulloreje, brenda afatit të vlefshmërisë së tyre.”;

v. në pikën 6, fjalia: “Hapja e një llogarie bankare, edhe në rastet kur ajo do të përdoret për kryerjen e transaksioneve në rrugë elektronike (e-banking account), kryhet vetëm me praninë fizike të klientit.”, zëvendësohet me fjalinë: “Për zbatimin e vigjencës së zgjeruar ndaj klientëve, subjektet duhet të kërkojnë praninë fizike të klientëve dhe të përfaqësuesve të tyre, para se të vendosin një marrëdhënie biznesi.”;

vi. pika 7, ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“7. Në rastin e përfaqësimit të klientit nga një person i tretë nëpërmjet një akti përfaqësimi, subjektet verifikojnë nëse ky person është i autorizuar për të përfaqësuar klientin dhe për të kryer veprimet e kërkuara, kërkojnë të dhëna për



identifikimin e klientit dhe të përfaqësuesit të tij dhe i verifikojnë këto të dhëna, si dhe mbajnë në dosjen e klientit të gjithë dokumentacionin e paraqitur prej personit të tretë, duke përfshirë dhe origjinalin ose kopjen e noterizuar të aktit të përfaqësimit.”;

vii. pas pikës 14, shtohen pikat 15 dhe 16 me përmbajtjet e mëposhtme:

“15. Subjektet që janë pjesë e grupeve bankare dhe/ose financiare, zbatojnë programet e grupit kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, për sa janë në përputhje me detyrimet e parashikuara në ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.

16. Subjektet, në rastin kur mbështeten në palë të treta, zbatojnë kërkesat e parashikuara në ligjin për parandalimin e pastrimit të parave.”;

f) Në nenin 8 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në pikën 6, togfjalëshi “nenet 8 dhe 9 të ligjit”, zëvendësohet kudo me fjalën “ligjin”;

ii. në pikën 8, pas togfjalëshit “për zbatimin e detyrimeve”, shtohet togfjalëshi “dhe të masave parandaluese”;

iii. në pikën 9, togfjalëshi “, për punonjësit e përfshirë në procesin e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, zëvendësohet me togfjalëshin “e punonjësve, veçanërisht të atyre të përfshirë në procesin e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”;

iv. pas pikës 9, shtohet pika 9/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

“9/1. Subjektet hartojnë dhe zbatojnë një program vjetor të trajnimit të personit përgjegjës dhe të punonjësve të strukturës përgjegjëse për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.”;

g) Në nenin 9 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në pikën 3, togfjalëshi “numrin e dokumentit të identifikimit, IBAN-in, në rastet kur është i aplikueshëm ose numrin e llogarisë”, zëvendësohet me togfjalëshin “numrin e dokumentit të identifikimit/ numrin personal ose IBAN-in (në rastet kur është i aplikueshëm), ose numrin e llogarisë,”;

ii. në pikën 3, pas fjalisë së parë, shtohet fjalia me përmbajtjen e mëposhtme:

“Në rast se nuk ka një numër llogarie, transfera shoqërohet nga një numër unik reference.”;

h) në nenin 10 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në pikën 2, pas togfjalëshit “gjatë procesit të mbikëqyrjes”, shtohet togfjalëshi “së subjekteve të kësaj rregulloreje”;

ii. pika 5, shfuqizohet;

i) Neni 12 shfuqizohet;

j) Pas nenit 12, shtohet neni 13 me përmbajtjen e mëposhtme:

“Neni 13

Masat mbikëqyrëse dhe ndëshkimore

1. Banka e Shqipërisë merr masa mbikëqyrëse dhe ndëshkimore ndaj subjekteve të kësaj rregulloreje, siç përvaktohet në ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe ligjin nr. 52/2016 “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre” dhe në aktet nënligjore në zbatim të tyre, të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtyre subjekteve, nëse konstaton se këto subjekte nuk zbatojnë kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

2. Banka e Shqipërisë, kur e gjykon të arsyeshme, mund të pezullojë një ose disa veprimtari apo të revokojë licencën e subjektit, në rastet kur kërkohet nga autoriteti përgjegjës, sipas ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave”;

k) Në aneksin 1, seksioni II, “Niveli i rrezikut”, kudo, togfjalëshi “e vigjilencës së dubur”, zëvendësohet me togfjalëshin “e vigjilencës së thjeshtuar dhe vigjilencës së dubur”;

l) Në aneksin 1, seksioni III, “Faktorët e rrezikut”, pika 3, shkronja “h”, pas togfjalëshit “prepaid card,” shtohet togfjalëshi “mjete virtuale,”;

m) Në aneksin 1, seksioni V, “Hapat e matjes së rrezikut”, togfjalëshi “në kategori të vigjilencës së dubur dhe të zgjeruar”, zëvendësohet me togfjalëshin “në kategori të vigjilencës së thjeshtuar, vigjilencës së dubur dhe të vigjilencës së zgjeruar”;

n) Në aneksin 1, seksioni VI, “Treguesit e dyshimtë”, pika 2, pas shkronjës “n” shtohet shkronja “o” me përmbajtjen e mëposhtme:

“o) transaksione që përfshijnë përdorimin e mjeteve virtuale.”;

o) Në aneksin 2, tabela “b”, “Hapat e matjes së rrezikut”, fjalia e fundit e shënimit shpjegues (footnote) për termin “Analiza sasiore”, ndryshon si më poshtë:

“Në çdo rast të përdorimit të koeficientëve të tjerë, institucioni duhet të ndërtojë një analizë, në përputhje me kërkesat ligjore për kategorizimin e çështjes në vigjilencë të dubur, të thjeshtuar apo të zgjeruar.”;

p) Në aneksin 2, tabela “c”, “Matrica e vlerësimit të kriterit”, në shënimin shpjegues (footnote), togfjalëshi “CDD=Vigjilencë e Dubur”, zëvendësohet me togfjalëshin “CDD=Vigjilencë e Dubur dhe e Thjeshtuar”;



q) Në aneksin 4, emërtimi i pikës 2.3 ndryshon në: *“Njih klientin tënd, vigjilenca e thjeshtuar, e dubur dhe vigjilenca e zgjeruar”*.

2. Ngarkohen subjektet e kësaj rregulloreje me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

VENDIM
Nr. 79, datë 18.12.2019

**PËR DISA NDRYSHIME NË
RREGULLOREN “PËR MBIKËQYRJEN
E KONSOLIDUAR”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nënkreut II, të kreut VI, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për mbikëqyrjen e konsoliduar”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 4, datë 1.2.2017, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 6, pika 1, shkronja “c”, togfjalëshi *“reputacional dhe ligjor”*, zëvendësohet me togfjalëshin *“reputacional, ligjor dhe të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”*;

b) Pas nenit 21, shtohet neni 21/1, me përmbajtjen e mëposhtme:

“Neni 21/1

**Kërkesat mbi parandalimin e pastrimit të
parave dhe financimit të terrorizmit**

1. Institucioni mbizotërues harton programe kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në nivel grupi, të cilat duhet të jenë të zbatueshme dhe të përshtatshme për të gjithë subjektet e grupit.

2. Programet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, parashikojnë midis të tjerash:

a) krijimin e strukturës së nevojshme nga institucioni mbizotërues në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në nivel grupi;

b) kritere mbi pastërtinë e figurës dhe integritetin e punonjësve, veçanërisht të atyre të përfshirë në procesin e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, të parashikuara në procedurat e brendshme të punësimit në nivel grupi;

c) një program vjetor të trajnimit të punonjësve të subjekteve të grupit, lidhur me çështje të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

d) politika dhe procedura për shkëmbimin e informacionit të nevojshëm, në kuadër të ushtrimit të vigjencës dhe të administrimit të rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

e) paraqitjen e informacionit mbi klientët, llogaritë dhe transaksionet nga subjektet e grupit të funksioni i përputhshmërisë, i kontrollit të brendshëm dhe/ose i parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në nivel grupi, kur ky informacion është i nevojshëm për qëllime të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

f) masa të mjaftueshme për ruajtjen e konfidencialitetit dhe përdorimin e informacionit të shkëmbyer.”.

2. Ngarkohen subjektet e kësaj rregulloreje me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.



Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETAR
Gent Sejko

VENDIM

Nr. 80, datë 18.12.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË
RREGULLOREN “PËR MBIKËQYRJEN
E TRANSAKSIONEVE BANKARE NË
RRUGË ELEKTRONIKE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 28, datë 30.3.2005, të bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

a) Neni 5, shfuqizohet.

2. Ngarkohen subjektet e kësaj rregulloreje me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETAR
Gent Sejko

NJOFTIM

Nr. 18189, datë 20.12.2019

**MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË
MARRËVESHJEJE DYPALËSHE
ME KATARIN**

Marrëveshja ndërkombëtare “Për transportin detar” ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Katarit, nënshkruar në datën 16.4.2019 në Doha të Katarit, do të hyjë në fuqi në datën 1.11.2019.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVOPËN DHE PUNËT
E JASHTME
Armand Skapi

KËRKESË

Shtetasja Rudine Toni kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, shpalljen të zhdukur të shtetasit Gjon Toni, i datëlindjes 24.6.1972, lindur dhe banues në Rrenc, Njësia Administrative Gur i Zi.

KËRKUESE
Rudine Toni

KËRKESË

Shtetasja Suzana Strazimiri, e datëlindjes 18.1.1953, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, shpalljen e vdekjes së shtetasit Burhan Strazimiri, i datëlindjes 18.2.1947.

KËRKUES
Suzana Strazimiri

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 476 lekë